

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

MENAXHIMI I MBETJEVE

ID 5.9 “Magazininim i përkohshëm I mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”

ID 5.11 “Kompostim i mbetjeve bio”.

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



SUBJEKTI: “CLEAN CITY” SH.P.K.

NIPT: L52223513S

VENDNDODHJA:

Durrës, Lagjja 15, Spitalë, të llojit tokë bujqësore arë me Nr. Pasurie 147/22, vol 22, faqe 175, Zona Kadastrale 8517.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti “Clean City” sh.p.k, është një subjekt privat i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(QKR) me Numër Identifikimi (NIPT): **L52223513S** dhe seli në **Durrës, Lagja 15, Rruga Miqësia, Kapanon 1 katësh, Zona Kadatrale 8517, Nr. Pasurie 283/3/ND, dhe Nr. Pasurie 283/3-III me sip. totale 294.1m²**, me Administrator **Juljana Bardhi**.

Ky subjekt, si objekt të aktivitetit të tij ka veprimtaritë: pastrim, gjelbërim, grumbullim, transport, rikuperim i mbetjeve urbane, mbetjeve industriale si dhe rikuperimin dhe asgjësimin e tyre. Shërbim nëpër autoritetet portuale dhe subjekte të tjera, terheqjen e mbetjeve jo të rrezikshme, terheqjen dhe transportimin e mbetjeve të ndotura urbane dhe llumrat nga gropat septike. Grumbullim, transportim i të gjitha mbetjeve jo të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre drejt venddepozitimeve përfundimtare. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme, urbane, ambalazheve, ujrave të ndotura urbane dhe ujerave të gropave septike. Stacion transferimi të mbetjeve jo të rrezikshme.

Qëllimi i kompanisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësisë dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e transferimit dhe rikuperimit të mbetjeve.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Subjekti “CLEAN CITY” sh.p.k., kërkon të aplikojë për Leje Mjedisore Tipi B, për të zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

ID 5.9 “Magazinim i përkohshëm I mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”

ID 5.11 “Kompostim i mbetjeve bio”.

Klasifikimi bazuar në ligjin 10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar:

Referuar sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

Shoqëria “Clean City” sh.p.k është një subjekt i cili do zhvillojë aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e Menaxhimit të integruar të mbetjeve jo të rrezikshme.

2.1. VENDODHJA E AKTIVITETIT

Subjekti do të zhvillojë aktivitetin në adresën **Durrës, Lagja 15, Spitallë, të llojit tokë bujqësore arë me Nr. Pasurie 147/22, vol 22, faqe 175, Zona Kadastrale 8517.**

Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjalë ndodhet në zonën e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik Spitallë, e distancuar nga zonat e banuara. Në anën veriore kufizohet me rrugën “Miqësia”, ndërsa në anët e tjera kufizohet me toka të pashfrytëzuara.

Ne hapësirën e percaktuar për zhvillimin e aktivitetit **ID 5.11 “Kompostim i mbetjeve bio”**, është menduar instalimi I nje mini stalle me sipërfaqe 202 m² e ndare ne 5 hapësira ne menyre qe te strehoje kafshe te ndryshme, ku secila hapësire ka nje mini oborr dedikuar kafsheve me sipërfaqe rreth 60 m² secili. Gjithashtu do te vendoset dhe zyra, tualeti dhe dhome veterinarie. Ministallat do te kene vetem per qellim terheqjen e turistevet, dhe nuk do te perdoren per mbarshkrimin e kafsheve. Stallat do te ndertohen me mure tulle dhe mbulesa e tyre te do jete cati nje ujese e mbuluar me llamarine. Lartesia maksimale eshte 4.07 m. Duke qene se stalla do te perdoret vetem ne funksion te Agroturizmit dhe ka nje kapacitet me te ulet sec e parashikon **Ligji 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”**) atehere subjekti “Clean City” nuk ka perse ta perfshije si aktivitet ne aplikimin per pajisjen me Leje B.

Nje pjese e sipërfaqes, me konkretisht rreth 1457 m² do te perdoret per perpunimin e plehut organik.

Ne nje hapësire rreth 500 m² është menduar instalimi I nje sere, e perballe saj ne pjesen anesore ne nje sipërfaqe prej 709 m² do te zhvillohet aktiviteti me ID **ID 5.9 “Magazininim i përkohshëm I mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”**



Nr	X	Y
1.	4372005.57	4580395.06

3. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

-Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikoje ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

4. PROCESI TEKNOLOGJIK

ID 5.9 “Magazinim i përkohshëm I mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.”

Ambjenti i ilustruar ne ortofoton e meposhteme, do të shërbeje për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve jo të rrezikshme, të ngurta dhe të lëngta, ku këto mbetje gjenerohen nga aktivitete të ndryshme në vendin tonë, dhe më pas subjekti Clean City Shpk do te kryeje transportimin e tyre drejt operatorëve të licencuar për asgjësimin përfundimtar.



ID 5.11 “Kompostim i mbetjeve bio”.

Instalimi I kompostimit te mbetjeve I planifikuar eshte nje fushe kompostimi e hapur dhe e thjeshte per mbetjet e kompostueshme. Qellimi I impiantit te kompostimit te mbetjeve eshte qe te prodhoje kompost te nje cilesie te mire nga mbetjet e meposhteme qe do te perdoren si lende e pare:

1. Çdo masë e njomë dhe pjesë e papërdorur bimore (degë, rrënjë, gjethe, lëvore, etj.)
2. Mbetjet e kulturave bujqesore te mbjella pergjate hapesires te destinuar per Agroturizem.
3. Mbetjet bimore të kuzhinës te gjeneruara nga Bujtina, pa marrë parasysh çfarë janë (p.sh. lëvore të patateve, bananeve, trangujve, qepëve, shalqinit, pjeprit, etj.)
4. Plehu i gjedhit, kafsheve qe do te rriten ne stallen e kompanise etj.
5. Mbeturinat nga peshqit (të freskët ose të ngordhur)
6. Bari i thatë duke përfshirë edhe sanën
7. Dheu pa gurë
8. Mbetjet e çajit dhe kafesë (llumi), përbëjnë ushqim jashtëzakonisht të mirë për mikroorganizmat dhe sidomos për krimbat e tokës. etj

Menyra e kompostimit do te jete me kavaleta. Siperfaqja e projektuar per procesin e kompostimit eshte 1457 m².

Ortofoto e meposhteme tregon ambientin ne funksion te aktivitetit “*Kompostim i mbetjeve bio*”.



- 1→ Stalla, ku perفشihet dhe zyra, Tualet dhe Dhome veterinare
- 2→ Ambienti ku do te kryhet kompostimi
- 3→Sera

Çfarë është komposti?

Ka shumë përkuzime për kompostin ose plehun organik, por ai që haset më së shumti e përcakton Kompostin si pleh organik pa erë ose me erë të pranueshme, të qëndrueshëm në kohë, të pasur me humus, i aftë që të lëshojë në tokë lëndë ushqyese, të përmirësojë strukturën e tokës duke ndihmuar qarkullimin e ajrit. Ai ofron mikroorganizma të dobishëm për kulturat e mbjella, dhe nxit rritjen e aparatit të tyre rrënjor.

Si funksionon kompostimi?


Kompostimi njihet më së shumti si procesi aerobik i cili shpërbën biologjikisht materialet në prani të oksigjenit (ajrit). *Nënproduktet kryesore të tij janë dioksidi i karbonit, uji dhe nxehtësia.* Kompostimi mund të jetë edhe proces anaerobik gjatë së cilit shpërbërja ndodh në mungesë të oksigjenit. Në këto raste nënproduktet kryesore janë metani, dioksidi i karbonit dhe disa alkoole dhe acide organike të dobët.

Duke qënë se kompostimi aerobik është më eficient, më i thjeshtë dhe shoqërohet me më pak nënprodukte të padëshirueshme, subjekti ka menduar të aplikojë këtë formë të kompostimit.

Fazat e procesit të kompostimit

Procesi bazik i kompostimit aerobik përfshin 5 hapa:

1. Përgatitja e materialit të kompostueshem;
2. Kompostimi;
3. Kurimi;
4. Kontrolli;
5. Depozitimi që në rastin tonë është ripërdorimi brenda sheshit



- Biomasa i nënshtrohet një procesi intensiv degradimi. Gjatë kësaj faze, kohëzgjatja e të cilës ndryshon në varësi të llojit të lëndës të përdorur, rritet temperatura dhe nën veprimin e mikroorganizmave biomasa çliron nxehtësi, avullon ujë dhe gaz (gaz karbonik). Që procesi të ketë rezultat, biomasa duhet të përgatitet dhe të homogjenizohet.

Proçeset e përgatitjes së biomasës përfshijnë procesin e *grirjes* dhe atë të *përzierjes*.

Ky proces ka për qëllim zvogëlimin e copave të materialeve me dimensione të mëdha (mbetjet që do të perdoren për kompostim) për të siguruar një material që garanton porozitetin e masës duke favorizuar kontaktin me ajrin të mikroorganizmave që bëjnë procesin e kompostimit.

Përzierja → Përzierja e lëndëve organike të mbetura është faza e procesit e domosdoshme për ato materiale që ndryshojnë shumë ndërmjet tyre për nga përmbajtja e lagështisë, dimensionet dhe konsistenca.

Kthimi → Kthimi ka për qëllim oksigjenimin e biomasës, shpërndarjen e nxehtësisë, largimin e lagështisë së tepërt dhe ndihmon në ndarjen e komponentëve të ndryshëm në grumbull. Frekuenca e këtij procesi është në varësi të drejtë me shkallën e fermentimit të materialit: materialet organike lehtësisht të degradueshme (plehu i freskët i bagëtive me pak material tjetër) kërkojnë që në 15-20 ditët e para të trajtimit të kthehen çdo 3-5 ditë.


Maturimi → Ky është vazhdim i fazës aktive të procesit dhe gjatë kësaj kohe kompostimi kryhet në mënyrë shumë të ngadalëshme. Grumbulli mund të mbahet siç është pa bërë kthimin ose ajrimin e detyruar të tij. Në kompostin përfundimtar nuk dallohen materialet që janë përdorur fillimisht, nuk ka erë ose ka erë të pëlqyeshme të ngjashme me atë të bimësisë nën drurët e pyllit dhe merr ngjyrë të errët.

Teknika e kompostimit

Subjekti ka zgjedhur të kryejë procesin e kompostimit me tekniken me paleta (Kavaleta)

Paletat

Në këtë teknikë kompostimi, materiali i kompostueshëm vendoset në rreshta paralele të ndarë nga hapësira të konsiderueshme. Paletat zakonisht bëhen në hapësira të pambuluara dhe bazohen në kombinimin e ajrosjes natyrore me përzierjen mekanike për të siguruar kushtet aerobike.



Avantazhet:

- e lehtë për tu realizuar;
- trajton një sasi të konsiderueshme lënde organike;
- nuk ka nevojë për eksperiencë.

Disavantazhet:

- disavantazhi kryesor është hapësira që kërkon, e cila është e madhe;
- në mot të ftohtë, ka nevojë për mbulim që të ruajë temperaturën;
- mund të prodhojë erë të keqe.

Mbulimi I materialit te kompostueshem

Eshte menduar mbulimi me pelhuren TopTeX[®]. Direkt pas vendosjes se mbulesave, ato mbulohen me shtresen TopTex[®] (gjeotekstile), per te ndaluar formimin e rrjedhjes dhe ne rast te temperaturave te thata, per te rujuar temperaturen qe I nevojitet procesit te kompostimit. Nje tjeter efekt pozitiv eshte mbrojtja nga rrezatimi UV, duke lejuar keshtu kushte optimale edhe ne siperfaqen e materialit te kompostimit.



Monitorimi I temperatures

Temperatura do te monitorohet cdo dite gjate periudhes se higjienizimit (10 dite >55°C). Nje temperature mbi 65°C eshte kriter per kthimin e kompostimit. Pas fazes se higjienizimit (temperature < ~ 45°C), temperature monitoriohet afersisht 2 here ne jave, me qellim te kontrollit te nivelit te metejshem te aktivitetit biologjik te maturimit.

***Komposti I perfunduar nuk duhet te riperdoret kur ruhet gjate ne periudhe te zgjatur dhe ndryshimi me temperature e tokes nuk duhet te tejkaloje 5°C.

Monitorimi I CO₂

Perqendrimi I CO₂ duhet monitoruar cdo dite gjate fazes intensive te dekompozimit (2-3 jave). Kjo do te behet me sonden e CO₂. Sapo permbajtja e CO₂ rritet mbi 12%, kjo tregon se permbajtja e O₂ ne dispozicion bie nen 5%. Ky eshte tregues se komposti eshte I prishur dhe nuk duhet te perdoret.

Ujitja

Gjate fazes se pare intensive ku vlerat e temperatures jane te larta (>50-55°C) dhe ndodh avullimi ne shkalle te larte, komposti ujitet duke sperkatur me uje ne menyre homogjene materialin kompostues perpara rrotullimit.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi.

Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë:

ID 5.9 “MAGAZINIM I PËRKOHSHËM I MBETJEVE DUKE PËRFSHIRË TEPRICAT E PRODUKTEVE NGA KONTEJNERËT OSE NGA LARJET E KONTEJNERËVE, DHE ÇDO MBETJE TË RREZIKSHME NË MJEDISËT PRITËSE TË NJË ZONE PORTUALE DHE KU MBETJET JANË MAGAZINUAR PËR JO MË SHUMË SE 7 DITË.”

Shkarkimet në ujë
Projekti në fjalë nuk parashikon përdorim të ujit për zhvillimin e procesit të menaxhimit të mbetjeve. Të vetmet ujra që mund të gjenerohen janë ato gjatë periudhës së reshjeve, të cilat mund të ndikojnë në shpëlarjen e mbetjeve dhe nëpërmjet rrjedhjeve të dëpërtojnë në ujrart sipërfaqësore e nëntokësore të zonës, si dhe në ndotjen e shtresave të tokës. Per kete arsye e gjithë sipërfaqja ku do të zhvillohet ky aktivitet eshte e shtruar me beton, duke mos lejuar keshtu rrjedhjet ne toke e rrjedhimisht nuk do te kete ndotje te saj.
Emëtimet në ajër
Ndotja e ajrit vjen si rezultat i përhapjes së pluhurave dhe gazeve që gjenerohen nga proceset e ngarkimit dhe shkarkimit të mbetjeve nga mjetet e transportit qe kompania perdor. Duhet theksuar se aktiviteti i përditshëm urban i automjeteve gjeneron ndotje më të madhe se sa përdorimi i mjeteve në sheshin ku do të zhvillohet aktiviteti. Duhet theksuar fakti se materiali që do të magazinohet përkohësisht, ka përmbajtje lagështie dhe densitet, gjë e cila e vështirëson mundësinë e përhapjes së grimcave të pluhurit.
Ndikimet në tokë
Ndikimet në tokë do të jenë minimale, kjo për vetë faktin se punimet që do të realizohen për përgatitjen e sipërfaqes ku do zhvillohet aktiviteti, do të zhvillohen në sheshin e shtruar më parë me beton/arme, duke e përjashtuar në këtë mënyrë mundësinë e kontaminimit të tokës
Zhurmat dhe vibrimet
Zhurmat që do të gjenerohen në mjedisin e sipërfaqes në fjalë, do të vijnë kryesisht nga mjetet dhe makineritë, që do të perdoren në aktivitet. Në rastet kur niveli i zhurmave i tejkalon normat kufi të zhurmës dhe përbën rrezik për punonjesit, atëherë do të përdoren masa mbrojtëse, në rastin konkret kufje. Vlerësimet për zhvillimin e aktiviteteve të tilla, rezultojnë se nuk do të kemi gjenerim të zhurmës në nivele të larta dhe që mund të ndikojë në mjedisin e zonës përreth dhe punonjësit.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT L52223513S

Objekti në fjalë ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zonat e banuara, duke mos ndikuar në aktivitetin e tyre të përditshëm.

Puna në objekt do të jetë në orare të kufizuara vetëm kur do të kemi procese të depozitimit dhe transferimit të mbetjeve, procese të cilat nuk zgjasin më shumë se 30 minuta nga momenti i shkarkimit dhe ngarkimit të mjeteve të transportit.

Ndikimet në florë/faunë

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zones në fjalë. Gjithashtu zona ku do ushtrohet aktiviteti do të jetë e shtruar me beton/arme, si dhe e rrethuar përgjatë gjithë perimetrit të saj.

Mbetjet e prodhuara

Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për transferimin dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme, nuk parashikojnë të gjenerojnë mbetje, pasi ky aktivitet konsiston pikërisht në menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenierëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

ID 5.11 “KOMPOSTIM I MBETJEVE BIO”.

Emëtimet në ajër

Ndikime ne ajer mund te permendim aromen e mbetjeve vetem ne fazen qe behen gati per t’iu nenshtruar proceseve te kompostimit. Por sic nenkuptohet, keto shkarkime jane ne interval shume te shkurter kohor. Materiali qendron gjate gjithe fazes se kompostimit I mbuluar duke mos gjeneruar keshtu shkarkime ne ajer.

Shkarkimet në ujë

Ky aktiviteti nuk shoqerohet me shkarkime ndotese ne ujerat siperfaqesor, nentokesor dhe kanalizime.

Ne kanalizime do te shkarkohen vetem ujerat nga perdorimet higjiene-sanitare, qe gjenerohen nga punonjesit. Por keto ujera nuk permbajne komponente qe mund te ndotin mjedisin uJOR prites.

Ndikimet në tokë

Per vete natyren e aktivitetit, ai nuk shoqerohet me ndikime negative në tokë.

Zhurmat dhe vibrimet

Aktiviteti kompostim I produkteve bio nuk shoqerohet me zhurma dhe as vibrime.

Ndikimet në florë/faunë

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zones në fjalë. Përkundrazi, me arritjen e prodhimit te kompostit, ai do te perdoret per te pleheruar siperfaqet e mbjella, te cilat subjekti do t’i perdore ne funksion te Agroturizmit.

Mbetjet e prodhuara

Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për kompostimin e mbetjeve bio, nuk parashikojnë të gjenerojnë mbetje.

Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenierëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

6. MASAT ZBUTESE DHE PARANDALUESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

MJEDISI	MASAT PARANDALUESE TE PROPOZUARA
Toka	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kryerja e aktivitetit brënda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit. ▪ Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve
Erozioni	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e instalimit për ruajtjen/magazininimin transferimin dhe rikuperimin e mbetjeve. ▪ Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut. ▪ Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të sipërfaqes së objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. ▪ Mirëmbajtja e sipërfaqes ku do të zhvillohet aktiviteti.
Biodiversiteti / Vegjetacioni	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria.
Cilesia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtës. ▪ Mjete me kolaudim optimal. ▪ Pjesë këmbimi rezervë brenda objektit për raste emergjente. ▪ Plan veprimi në rast rrjedhjesh. ▪ Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. ▪ Përdorim i karburanti cilësor. ▪ Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës. ▪ Pastrimi periodik i stacionit të menaxhimit të mbetjeve, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Mbetjet	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësia vendore. ▪ Asgjësimi i mbetjeve që vijnë nga stacioni i transferimit dhe rikuperimit, nga kompani të licensuara.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NIPT L52223513S

Zhurmat	<ul style="list-style-type: none">▪ Përdorimi i mjeteve të kolauduara.▪ Përdorim i stacionit të menaxhimit të mbetjeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.▪ Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).▪ Puna në objekt do të jetë në orare të kufizuara vetëm kur do të kemi procese të depozitimit dhe transferimit të mbetjeve, procese të cilat nuk zgjasin më shumë se 30 minuta nga momenti i shkarkimit dhe ngarkimit të mjeteve të transportit.
Trafiku rrugor	<ul style="list-style-type: none">▪ Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.▪ Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

“CLEAN CITY” SH.P.K.

Administrator

Juljana Bardhi